35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Paguesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 203-24-5997-5-2-1/C185

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 35,982.785 EURO me kohëzgjatje prej 90 ditësh
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000-euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 10 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë pune pas urdhrat për fillimin e punimeve.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e

		Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>Bedri Dobra</i> .
Parimet përgjithshme e pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga 30,000.00 € për punët e kryera dhe te konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar ose kompania e sigurimeve “me kërkesë”. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve (2 vite)
Shkaqet për kompensim	30.1	Sipas nenit 30 të Kushteve të Përgjithshme.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara. Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e punëve, është vlera e punëve të kryera të pranueshme. Nëse me fajin e OE vjen deri te shkëputja e kontratës atëherë me marrëveshje te palëve automatikisht shkëputet kontrata dhe pasojnë dënimet për OE si: nuk paguhet mjete nga MBPZHR-së për punët e pakryera dhe llogariten demet e shkaktuara për moskryerjen dhe zhegjitjen e punimeve qe i paguan pune kryesi dhe automatikisht i konfiskohet sigurimi i ekzekutimit shuma 10% e vlerës totale te kontratës në MBPZHR-së.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën komerciale në pajtim me ligjin në Kosovë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



RAPORTI TEKNIK I EKZEKUTIMIT

Hapsira: Objekti i MBPZHR-se ne Ulpiane


Lokacioni: *Prishtinë*

Investitor: Ministria e Bujqesise, Pylltarise dhe Zhvillimit Rural

Punoi: *Primo Studio SH.P.K*

Datë: *Prill 2024*

PRIMO STUDIO SH.P.K



Përmbajtja

RAPORTI TEKNIK I EKZEKUTIMIT	1
Hapsira: Objekti i MBPZHR-se ne Ulpiane	1
PËRSHKRIMI I OBJEKTIT.....	3
PËRSHKRIMI I POZICIONEVE.....	3
PUNET PREGATITORE DHE PUNET E DEMOLIMIT	3
PUNET E RENOVIMIT	3
PUNET E KULMIT.....	4
PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES	4
PUNET E PLLAFONIT.....	5
PUNET E DYSHEMESE.....	5
PUNET E DYERVE DHE DRITAREVE	5
PUNET ELEKTRIKE	6
PUNET E MAKINERISE	6
FOTOGRAFI TE GJENDJES EKZISTUESE.....	7

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

Objekti është i vendosur në zonë urbane, me saktësi në Ulpiapë me etazh të B+P+2. Intervencimet janë parapare të bëhen në bodrum dhe në katin 2 të objektit. Gjendja strukturore e objektit është stabile, ndërsa ka nevojë urgjente për intervenime dhe sanime në aspektin arkitektonik. Destinimi i objektit është parapare për shfrytëzim sipas nevojave të MBPZHR-se, respektivisht Bodrumi si Arkivë ndërsa Kati 2 si hapësirë administrative. Sipërfaqja totale e hapësirave të parapara për intervenim është 600m².

PËRSHKRIMI I POZICIONEVE

PUNET PREGATITORE DHE PUNET E DEMOLIMIT

Para fillimit të punimeve Kompania punëkryese duhet të ketë koordinim të plotë me akteret përgjegjës të kontratës lidhur me implementimin e duhur të planit të intervenimeve. Të merren masat e sigurisë brenda dhe përreth objektit. Të bëhet pozicionimi i makinerive të nevojshme në pozicionet ku nuk rrezikohet qarkullimi dhe objektet përreth.

Të gjitha materialet të cilat demolojnë gjatë punimeve sipas përshkrimit në specifikimin Teknik duhet të barten nga Kontraktori deri në deponime me të afërt legale të materialeve inerte dhe të tjera.

Kontraktori merr përgjegjësi për të gjithë procesin në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

PUNET E RENOVIMIT

Duke u bazuar në të dhënat e marra nga inqizimet në terren dhe nevojave për intervenime është përgatitur specifikimi Teknik i bashkangjitur në dosjen e projektit në të cilin parashihen një vëllim i caktuar i punëve të ndryshme ndërtimore me karakter renovues.

PUNET E KULMIT

Kulmi i Objektit eshte i sistemit kulm i rrafshet dhe i perbere prej shtresave te renditura si ne vijim: Pllaka e kulmit, hidroizolimi, zhavori. Nga inspektimet vizuale dhe konkrete eshte verejtur se ka shume hapesira ne te cilat ka deshtuar hidroizolimi i kulmit, si pasoje e kesaj verehen demtime te medha ne muret dhe pllafonin e hapsirave ne katin 2, te cilat jane ndikuar nga lageshtia. Per kete arsye para se te fillohet me renovime te brendshme kontraktori eshte i obliguar qe te beje intervenimet ne kulm ashtu siq jane parapa ne specifkimin teknik.

Kulmi do te demolohet sipas shtresave te renditura dhe do te aplikohen shtresat e reja si ne vije:

- Aplikimi i hidroizolimit (PVC)
- Aplikimi i gjeotekstilit i cili sherben per mbrojtjen e shtreses hidroizoluese
- Furnizimi dhe mbushja me zhavor ne te gjitha siperfaqen e kulmit per mbrojtje te shtresave izoluese

Gjithashtu eshte parapare edhe intervenimi ne llamarine pergjate perimetrit te objektit dhe riparimi, fiksimi, nderrimi i olluqeve sipas nevojës.

PUNET E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES

Duke pas parasysh gjendjen e mureve pas ndikimit te lageshtise eshte propozuar qe fillimisht te behet demolimi i tapeteve, derrasave dhe materialeve tjera te ngjitura ne mure, me pastaj duhet te behet gerryerja, pastrimi, intervenimet me glet dhe sipas nevojës intervenime me minimale me fug fuller. Si perfundim shtresa finale duhet te aplikohet me baze dhe dy shtresa ngjyre.

Ne pjeset ku demtimet jane me te medha (raste te kufizuara ne bodrum) duhet te aplikohen shtresa e murit nga Suvaja, rrjeta, masa rrafshuese, glet final dhe dy shtresa ngjyre.

Materiali i perdorur duhet te jete kualitativ dhe duhet te kontrollohet nga akteri pergjegjes i caktuar nga Autoriteti Kontraktues para realizimit te secilit pozicion.

PUNET E PLLAFONIT

Sistemi ekzistues i pllafonit eshte konstruksion druri ne te cilin jane te varur kapaket nga knaufi. Eshte parapare qe komplet ky sistem te demolohet dhe te aplikohet pllafoni i ri sistem "Amstrong" me konstruksion mbajtes dhe panela me dimensione (60x60)cm. Te gjitha mbetjet pas demolimit te pllafonit duhet te largohen dhe te barten ne depone sipas kerkeses ne piken e pare te ketij Raporti Teknik.

PUNET E DYSHEMESE

Dyshemeja e bodrumit eshte e aplikuar me keramika gjendja e te cilave eshte e pranueshme ndersa dyshemeja ne katin 2 eshte mjaft e demtuar si pasoje e rrjedhes se ujit nga Kulmi. Ne bodrum eshte parapare gerryerja dhe pastrimi i keramikave me preparate speciale te cilat nuk e demtojne teksturen e tyre dhe nuk kane ndikim negativ ne ambient. Per katin e dyte do te aplikohet dysheme e re nga Laminati me fuga me trashesi minimale $t=8\text{cm}$ dhe shtresa percjellese sipas specifikimit teknik. Ne hapsirat e banjove jane parapare dysheme prej keramikave te klasit te pare te cilat duhet te aplikohen edhe pergjate mureve anesore deri ne lartesine $h=1.50\text{cm}$

PUNET E DYERVE DHE DRITAREVE

Dritaret ne hapsirat ne bodrum jane ne gjendje relativisht te rregullt. Duhet te intervenohet ne mekanizmat e tyre ne menyre qe te kalibrohen dhe te jene funksionale. Dritaret ne katin e dyte jane ne gjendje jo te mire. Kornizat e dritareve jane te demtuara dhe nga material me performanca termike te dobeta, rrjedhimisht duhet qe te nderrohen komplet dritaret ne katin 2. Te gjitha mbetjet pas demolimit te pllafonit duhet te largohen dhe te barten ne depone sipas kerkeses ne piken e pare te ketij Raporti Teknik. Dritaret e reja qe do te montohen jane nga material PVC, me xhame dyshtesore me performanca termike (njeri xham katerstinor).








PUNET ELEKTRIKE


Pas shqyrtimeve ne terren eshte vertetuar se sistemi shperndares elektrik eshte pjeserisht funksional dhe duhet te intervenohet ne disa pozicione te caktuara. Sistemi i furnizimit kyqe eshte sistem i vjeter dhe duhet te aplikohen siguresat e reja qe perfshijn te gjithë njesine. Duhet bere testime ne terren dhe furnizimi me ndriques, priza, nderpresa, sisteme te IT-se sipas specifikimit teknik. Ndriqimi i sallave dhe i koridoreve eshte i ndryshem varsisht nevojës. Ndriquesit duhet te jene ekonomik, LED, sipas dimensioneve, kapacitetit dhe jetegjatesise te pershkruara ne specifikim teknik.

PUNET E MAKINERISE

Gjithsej ne hapsirat e paparapara per intervenim gjendet 3 banjo, te cilat perpos puneve arkitekture dhe elektrike duhet te aplikohet edhe ventilimi i tyre sipas permasave te parapara ne specifikim teknik. Sistemi i ngrohës eshte i vendosur nga ngrohëtorja e qytetit dhe eshte parapa vetem furnizimi me radiator dhe elemente tjera percjellese me dimensione te ndryshme varesisht vellimit te hapsirave perkatese.

FOTOGRAFI TE GJENDJES EKZISTUESE





ARKITEKTURA

EMERTIMI I VIZATIMIT

TE DHENA TJERA

VULA DHE NENSHKRIMI

"Primo Studio" S.H.P.K.

Email: primostudio.11c@gmail.com

Str. "Ahmet Gashi" Prishtine

Tel: +383 49 541 877

OBJEKTI I MBPZHR-se NE ULPIANE

BAZA E BODRUMIT

PERPJESA:



1:100

DATA:

PRILL, 2024

PRIMO
STUDIO



D-01



Dere me konstrukcion druri
me panele mbeshitjelse
mekanike rezistente. Mbushja
ne mes paneleve te sherbeje
per rritjen e nivelit te izolimit
akustik

COPE	Dimensionet	Lloji
8	90 x 200	POS D-1
Data: Pril. 2024		
"Primo Studio" SHPK. Email: primostudio.k@gmail.com Str. "Ahmet Cashi" Prishtine Tel: +383 49 541 677 +383 49 695 046		 PRIMO STUDIO



D-02



Dere me mbindrigim,
konstruksjon druri me panele
mbeshirjellese mekanike
rezistente. Mbushja ne mes
paneleve te sherbeje per
rritjen e nivelit te izolimit
akustik

COPE	Dimensionet	Lloji
22	95 x 270	POS D-2
"Primo Studio" SHPK. Email: primo.studio.k@gmail.com Str. "Ahmet Cosh" Prishtine Tel: +383 49 541 677 +383 49 695 046		
		PRIMO STUDIO

D-03







Dere me mbindrigim,
konstrukcion druri me panele
mbeshjtjellëse mekanike
rezistente. Mbushja në mes
paneleve të shërbejë për
rritjen e nivelit të izolimit
akustik

COPE	Dimensionet	Lloji
7	80 x 270	POS D-3
	Data:	
	Pril, 2024	

"Primo Studio" SHPK.
Email: primostudio.kc@gmail.com
Str. "Ahmet Cosh" Prishtine
Tel: +383 49 541 677
+383 49 895 046



DR-08



Karakteristika teknike

Numri i xhamave	3 xhoma
Gjeresia e kornizes	175 mm
Thelresa	80 mm
Trashësia e xhamit	≤ 52 mm
Koeficienti i termik	≤ 0.94 W/m²K
Izolimi akustik	47 dB

COPE

2

Dimensionet

245 x 220

Data

Pril 2024




Lloji

POS
DR-08

"Primo Studio" SHPK.
Email: primostudio1@gmail.com
Str. "Ahmet Coshi" Prishtine
Tel: +383 49 541 677
+383 49 895 046



DR-06



Karakteristika teknike

Numri i xhamave	3 xhama
Cjeresja e kornizes	175 mm
Thelësia	80 mm
Troshtësia e xhamit	≤ 52 mm
Koeficienti i termik	≤ 0.94 W/m²K
Izolimi akustik	47 dB

COPE

15

Dimensionet

240 x 150

Data:

Pril 2024





Lloji

POS
DR-06

"Primo Studio" SHPK.
Email: primo.studio@protonmail.com
Str. "Ahmet Gashi" Prishtine
Tel: +383 46 541 677
+383 46 695 046



DR-07



Karakteristika teknike

Numri i xhamave	3 xhama
Gjeresia e kornizes	175 mm
Thelësia	80 mm
Troshësia e xhamit	≤ 52 mm
Koeficienti i termik	≤ 0.94 W/m²K
Izolimi akustik	47 dB

COPE

5

Dimensionet

180 x 155

Data:

Prill, 2024

Lloj





POS
DR-07

"Primo Studio" SHPK.
Email: primo.studio@tigm.com
Str. "Ahmet Cosh" Prishtine

Tel: +383 49 541 677
+383 49 895 046



DR-09



Karakteristika teknike





Numri i xhamave	3 xhoma
Gjerësia e kornizes	175 mm
Thelësis	80 mm
Troshtësia e xhamit	≤ 52 mm
Koeficienti i termik	≤ 0.94 W/m ² K
Izolimi akustik	47 dB

COPE	Dimensionet	Lloji
2	80 x 90	POS
	Data	DR-09
	Prill 2024	

"Primo Studio" SHPK.
Email: primo.studio@k.com
Str. "Ahmet Gashi" Prishtine
Tel: +363 49 541 677
+363 49 895 046



DR-10



Karakteristika teknike

Numri i xhamave	3 xhoma
Gjerësia e kornizes	175 mm
Thelësi	80 mm
Trashësia e xhamit	≤ 52 mm
Koeficienti termik	≤ 0.94 W/m²K
Izolimi akustik	47 dB

COPE

2

Dimensionet

90 x 120

Data:

Prill, 2024

Lloji





POS
DR-10

"Primo Studio" SHPK.
Email: primo.studio@ic@gmail.com
Str. "Ahmet Coshi Prishtine"

Tel: +383 46 541 677
+383 46 895 046



DR-II



Karakteristika teknike

Numri i xhamave	3 xhamave
Gjerësia e kornizës	175 mm
Thelësia	80 mm
Troshtësia e xhamit	≤ 52 mm
Koeficienti i termik	≤ 0.94 W/m ² K
Izolimi akustik	47 dB

COPE	Dimensionet	Lloji
1	180 x 150	POS DR-II
	Data	
	Prill 2024	

"Primo Studio" SHPK.
Email: primo.studio@igmal.com
Str. "Ahtmet Coshi" Prishtine
Tel: +363 49 541 677
+363 49 695 046





Limit Project
Construction, design,
investments, consulting

LISTA E STAFIT PROFESIONAL

Lista e stafit për projektin me:

Titulli i kontratës: Renovimi i objektit të MBPZHR- së ne Ulpian Prishtinë për pjesën që aktualisht është për shfrytëzim nga MBPZHR

Nr.i Prokurimit: 203-24-5997-5-2-1

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nr. personal	Titulli i Diplomimit	Pozita	Provoja e Punës
1	Masar Kabashi	1005784138	Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturë	Menaxher i Kontratës Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturë	Mbi 10 vite
2	Fatmir Krasniqi	1012531032	Inxhinier i Ndërtimtaris-Drejtimi Konstruktiv	Inxhinier i Ndërtimtaris-Drejtimi Konstruktiv	Mbi 7 vite
3	Ekrem Tahiraj	2014659717	Inxhinier i Ndërtimtaris-Drejtimi Konstruktiv	Inxhinier i Ndërtimtaris-Drejtimi Konstruktiv	Mbi 7 vite
4	Dukagjin Ramqaj	1170471047	Inxhinier i Elektros-Drejtimi Elektronik	Inxhinier i Elektros-Drejtimi Elektronik	Mbi 5 vite
5	Fevzi Jetullahu	1014849528	Inxhinier i Ndërtimtaris-Drejtimi Hidroteknik	Inxhinier i Ndërtimtaris-Drejtimi Hidroteknik	Mbi 3 vite
6	Gazmend Krasniqi	1173753744	Inxhinier i Makineris-Drejtimi Termoenergjetik	Inxhinier i Makineris-Drejtimi Termoenergjetik	Mbi 3 vite
7	Heset Hajdini	1171442237	Inxhinier i Makineris-Drejtimi Termoenergjetik	Inxhinier i Makineris-Drejtimi Termoenergjetik	Mbi 3 vite

LIMIT PROJECT SH.P.K



PRISHTINË,
DATA; 27.06.2024



Limit Project

Construction, design,
investments, consulting

LISTA E STAFIT TEKNIK DHE STAFIT TE ÇERTIFIKUAR PER SIGURI DHE SHENDET NE PUNE

Titulli i kontratës: Renovimi i objektit të MBPZHR- së ne Ulpian Prishtinë për pjesën që aktualisht është për shfrytëzim nga MBPZHR

Nr.i Prokurimit: 203-24-5997-5-2-1

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nr. personal	Pozita
1	Burim Zariqi	1231836850	Moler
2	Mustafe Topalli	1014234213	Fasader
3	Musa Zariqi	1014232822	Zdrukthtar
4	Metush Smajli	1002146203	Teknik i elektroinstalues
5	Arber Topalli	1242180018	Teknik i elektroteknikes
6	Besnik Mustafa	1015352031	Teknik i elektroteknikes
7	Fidan Ramadani	1172790328	Elektroteknik
8	Armend Zaraj	1015508805	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
9	Bekim Demaku	1172793572	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
10	Leotrim Deliu	1241406101	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
11	Deli Delija	1242888002	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
12	Diamant Heta	1242543641	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
13	Mergim Delija	1242887383	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
14	Arian Seferi	1250381723	I çertifikuar per siguri dhe shendet ne pune
15	Bahri Olluri	1015751327	Puntor teknik
16	Ervis Beqiri	1247694664	Puntor teknik

LIMIT PROJECT SH.P.K

Lulzim Zaraj, Drejtör

LIMIT PROJECT

Prishtinë

PRISHTINË,
DATA: 27.06.2024


LIMIT PROJECT" SH.P.K., tel: 044 401 976; e-mail: limitproject.shpk@gmail.com



Lista Automjeteve dhe manikerive

No.	Description of Product	Quantity	Type	Production year	Registration No
1	Eskavator	1	Neuson Tipi 6003	2005	/
	Eskavator Bobcat	1	TEREX	2010	/
2	Kamionete me kran kiper 2 dyer	1	IVECO	1999	01-680-PN
3	Kamionete dubelkabine kipper me 4 dyer	1	IVECO	2004	01-733-ZP
4	Furgon kombi	1	OPEL F7	2004	01-514-DU
4	Furgon kombi	1			01-514-DU
5	Pik up	1	Opel Combo	2009	01-752-PS
6	Automjet	1	Tiguan vv	2012	01-224-OS
7	Eskavator bager me zingjir min 6 ton	1	LIEBEHERR-nr serik 552151	1995	/
8	Bager(mini eskavator) max. 3 ton	1	VOLVO – ECR28-G	2007	/
9	Kamion min 10 m3	4	MAN, Mercedes Benz		01-369-ZF 03-507-IH 03-506-IE 03-472-IC

05.07.2024






Lista e mjeteve

No.	Description of Product	Quantity
1	Cekic elektrik Trapan	11
2	Kompresor ajri per thyerje max. 1 ton	1
3	Pajisje matëse laserike	1
	GPS per matje gjeodezike	1
3	Skele	1
4	Burmashina	6
5	Shpuese	2
6	Shllajefrice	5
7	Motorsharre	1
8	Sharre per prerjen e betonit	1
9	Mikser C-Mix per perzierje te materialit	2
10	Sharre elektrike	1
11	Hillta Trapan pneumatik	2
12	Burgia	11
13	Shkalle	5
14	Prerese te armatures	4



15	Lakese armature	1
16	Prerese asfalti	2
17	Kompresor ajri	1
18	Gjenerator min 15KW	2
19	Sharre per prerjen e metalit	1
20	Laser rrotullues GRL 500HV	1
21	Sharre per prerjen e betonit	1
22	Kuti per mjete	4
23	Karroce (kolice)	1
24	Ngjeshes dheu	1
25	Makina per suvatim	2
26	Makine per prerjen e qeramikave	1

05.07.2024





Limit Project
Construction, design,
investments, consulting

DEKLARATË E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË DETYRUESHME

LIMIT PROJECT SH.P.K me seli në Prishtinë, Rr. Ahmet Gashi L1, H3, 1 numër unik të biznesit NUI: 811312561, e përfaqësuar nga Lulzim Zaraj, drejtori, deklarojmë se do t'i përmbushim kërkesat e AK me të gjitha punimet mallrat dhe materialet e nevojshme për intervenim, të cekura në **ANEKS 1 - SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**, dhe do t'i kryej punimet me përgjegjësi të plotë me kualitetin e kërkuar sipas këtij aneksi 1, sipas dosjes së tenderit për projektin:

Titulli i kontratës: Renovimi i objektit të MBPZHR- së në Ulpian Prishtinë për pjesën që aktualisht është për shfrytëzim nga MBPZHR
Nr. i Prokurimit: 203-24-5997-5-2-1

Investitori: MIN. E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL



Prishtinë
27.06.2024



Limit Project
Construction, design,
investments, consulting

DEKLARATË PËR FILLIMIN DHE PERFUNDIMIN E KONTRATES

Limit Project SHPK – me seli ne Prishtine, Rr. Ahmet Gashi, H1, L3, 1, me numër unik të biznesit NUI: **811312561**, e përfaqësuar nga Lulzim Zaraj drejtor, deklaron se do te filloje dhe perfundojë sipas afatit kohor:

Kontrata publike ka kohëzgjatje prej 60 dite pune , sipas dosjes së tenderit për projektin:

Titulli i kontratës: Renovimi i objektit të MBPZHR- së ne Ulpian Prishtinë për pjesën që aktualisht është për shfrytëzim nga MBPZHR
Nr.i Prokurimit: 203-24-5997-5-2-1

Investitori: MIN.E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL

LIMIT PROJECT SH.P.K

Lulzim Zaraj, drejtor



PRISHTINË,
DATA: 27.06.2024

SPECIFIKIMI TEKNIK PER PUNET E RENOVIMIT NE OBJEKTIN NE ULPIANE					
A. PUNET E RENOVIMIT		Njësia	Sasia	Çmimi për Njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
Pos	Pershkrimi i puneve				
KATI 3					
A) KORIDORI I PERBASHKET NE HYRJE					
HAPSIRA NR.1					
1	Largimi(Levizja) e inventarit dhe mbejtjeve tjera nga koridori deri ne perfundim te plote te punimeve dhe bartja e tyre deri ne deponine me te afert legale. Varesisht kerkeses te mbikqyresit te punimeve.	Komplet	1	€ 2,000.00	€ 2,000.00
2	Demolimi i shtresave te dyshemese ne pushimore ndermjet dy dyerve deri te pllaka e Betonit dhe pregatitja e dyshemese sipas nevojës per montimin e dyshemese se re.	m2	7	€ 10.00	€ 72.00
3	Demolimi i tepihut pergjate shkalleve. Materialet duhet te transportohen deri ne deponine me te afert legale.	m2	15	€ 5.00	€ 73.80
4	Demolimi i tapeleve te murit dhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	100	€ 5.00	€ 500.00
5	Demolimi i pllafonit te varur ekzistues nga kapaket e knaufit. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	24	€ 10.00	€ 240.00
6	Demolimi i konstruksionit mbajtes nga druri ne pllafon dhe te gjitha elementet tjera te varura ne pllafon. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	24	€ 10.00	€ 240.00
7	Pastrimi i pllafonit nga mbejtje te ndryshme inerte. Materiali duhet te bartet deri ne deponine me te afer legale.	m2	24	€ 10.00	€ 240.00
8	Demolimi i dritareve te drurit me dimensione (2.45x2.20)m dhe bartja e materialit deri ne deponin me te afert legale.	Cope	1	€ 100.00	€ 100.00
9	Furnizimi me material dhe ljerja e gardhit me ngjyre druri per pjeset me dru dhe me ngjyre te pershtatshme per konstruksionin metalik.	m1	13	€ 100.00	€ 1,300.00
10	Furnizimi, transporti dhe montimi i Dritareve te jashtme nga PVC, me xhame dyshtesore dhe performanca termike (njeri xhame katerstinor). Mundesia e hapjes ne krah dhe kiper. Dimensionet (2.45x2.20)m Ne cmim te kalkulohet edhe riparimet e nevojshme te perimetrit te murit pas montimit te dritareve te reja Dimensionet e ramit dhe dritareve te merren nga projekti, Referohuni Detallit Dr-02 ne projekt. Verejtje: Kontraktori eshte i obliguar qe matjet ti beje ne vend nenshtet dimensioneve te paracaktuara ne projekt	Cope	1	€ 2,964.50	€ 2,964.50
11	Furnizimi me material, pastrimit, izolimi dhe ngjyrosja e mureve dhe pllafonit te hapsires me baze dhe dy shtresa ngjyre dykomponenteshe akrilike. Ne cmim te kalkulohet edhe grryerja dhe permirsimi i murit, intervenimi me fug fuller dhe glet per permirsimin e pjeseve te demtuara te murit. Eliminimi i lageshtise ne perimetrin e mureve permes aparatures per eliminimin e lageshtise e cila duhet te aplikohet minimalisht 10 dite.	m2	100	€ 6.00	€ 600.00
12	Furnizimi me material dhe aplikimi i dyshemese "EPOX" ne te gjitha siperfaqen e pushimores (parahyrjes). DysHEMEJA duhet te jete e kualitetit te larte, rezistente ndaj ferkimit dhe leht e mirmbajtshme. Llajset anesore me lartesi minimale t=8cm. Ne cmim te kalkulohen edhe te gjitha materialet tjera lidhese dhe percjellese per ekzekutim te plote te pozicionit. Ngjyra te perzgjidhet nga investitori.	m2	7	€ 38.00	€ 273.60

13	Furnizimi dhe montimi i tepihut industria me trashësi minimale t=0.5cm. Ne cmim te kalkulohen te gjitha materialet lidhese dhe perçjellese deri ne ekzekutimin e plote te pozicionit. Tepihu te paloset edhe ne pjeset anesore pergjate shaklleve dhe pushimoreve. Ngjyra dhe tekstura te perzgjidhet nga investitori.	m2	15	€ 45.00	€ 664.20
14	Furnizimi me material dhe aplikimi i plafonit te leshuar te tipit "Amstrong" ne te gjitha siperfaqen e plafonit. Ne cmim te kalkulohen demontimi i konstruksionit ekzistues dhe pjeset perçjellese te konstruksionit deri ne perfundim te plote te pozicionit. Mbi konstruksionin e amstrongut te vendoset folia mbrojtese e cila sherben per mbrojtjen e plafonit amstrong nga lageshtia.	m2	24	€ 35.00	€ 840.00
TOTALI A) - KORIDORI I PERBASHKET					€ 10,108.10
B) HAPSIRAT MAJTAS KORDIORIT HYRES, NR. (2-16)					
HAPSIRA NR.2					
1	Largimi(Levizja) e inventarit dhe mbetjeve tjera nga salla/zyra deri ne perfundim te plote te punimeve dhe bartja e tyre deri ne deponine me te afert legale. Varesisht kerkeses te mbikqyresit te punimeve.	komplet	1.0	€ 2,000.00	€ 2,000.00
2	Demolimi i shtresave te dyshemese deri te pllaka e Betonit dhe pregatitja e dyshemese sipas nevojës per montimin e dyshemese se re.	m2	1.9	€ 10.00	€ 18.70
3	Demolimi i tapeteve te murit dhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	15.1	€ 5.00	€ 75.60
4	Demontimi i deres se bashku me kornize dhe xhamin e mbindriqimit. Transporti i materialeve deri ne deponine me te afert legale.	Cope	1.0	€ 50.00	€ 50.00
5	Demolimi i plafonit te varur ekzistues nga kapaket e knaufit. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	2.0	€ 10.00	€ 20.00
6	Demolimi i konstruksionit mbajtes nga druri ne plafon dhe te gjitha elementet tjera te varura ne plafon. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	2.0	€ 10.00	€ 20.00
7	Pastrimi i plafonit nga mbetje te ndryshme inerte. Materiali duhet te bartet deri ne deponine me te afert legale.	m2	2.0	€ 10.00	€ 20.00
8	Furnizimi me material, pastrimit, izolimi dhe ngjyrosja e mureve dhe plafonit te hapsires me baze dhe dy shtresa ngjyre dykomponenteshe akrilike. Ne cmim te kalkulohet edhe grryerja dhe permirsimi i murit, intervenimi me fug fuller dhe glet per permirsimin e pjeseve te demtuara te murit. Eliminimi i lageshtise ne perimetrin e mureve permes aparatures per eliminimin e lageshtise e cila duhet te aplikohet minimalisht 10 dite.	m2	15.0	€ 15.00	€ 225.00
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i laminati me fuga, trashësi d=8mm, llajsnave anesore si dhe folisë. Ngjyra dhe tekstura te zgjidhen nga investitori. Në cmim të llogariten të gjitha pjesët e nevojshme. Pagesa bëhet për m² të montuar komplet	m2	1.9	€ 35.00	€ 66.50
10	Furnizimi me material dhe aplikimi i plafonit te leshuar te tipit "Amstrong" ne te gjitha siperfaqen e plafonit. Ne cmim te kalkulohen demontimi i konstruksionit ekzistues dhe pjeset perçjellese te konstruksionit deri ne perfundim te plote te pozicionit. Mbi konstruksionin e amstrongut te vendoset folia mbrojtese e cila sherben per mbrojtjen e plafonit amstrong nga lageshtia	m2	1.9	€ 35.00	€ 66.50
11	Furnizimi, transporti dhe montimi derës me mbindriqim prej konstruksionit të drurit me panele mbeshjtëse mekanike rezistente, me dimenzione l=0.8m dhe h=2.70m dhe ngjyre te cilen e percakton investitori. Mbushja ne mes paneleve te sherbej per rritjen e nivellit te izolimit akustik. Dyert të punohen në bazë të detallit të dhënë. Ne cmim te kalkulohet edhe rregullimi i perimetrit te murit rreth derës pas montimit. Aprovimi i atesteve dhe materialeve per te gjitha specifikat e lartcekura behet nga shfrytzesi.	Cope	1.0	€ 850.00	€ 850.00

HAPSIRA NR.3					
1	Largimi(Levizja) e inventarit dhe mbetjeve tjera nga salla/zyra deri ne perfundim te plote te punimeve dhe bartja e tyre deri ne deponine me te afert legale. Varesisht kerkeses te mbikqyresit te punimeve.	komplet	1.0	€ 2,000.00	€ 2,000.00
2	Demolimi i shtresave te dyshemese deri te pllaka e Betonit dhe pregatitja e dyshemese sipas nevojës per montimin e dyshemese se re.	m2	2.6	€ 10.00	€ 25.50
3	Demolimi i tapeteve te murit dhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	17.3	€ 5.00	€ 86.40
4	Demontimi i ramit nga druri dhe xhami dhe deres se bashku me kornize dhe xhamin e mblidhjes. Transporti i materialeve deri ne deponine me te afert legale.	Cope	1.0	€ 50.00	€ 50.00
5	Demolimi i plafonit te varur ekzistues nga kapaket e knaufit. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	2.6	€ 10.00	€ 26.00
6	Demolimi i konstruksionit mbajtes nga druri ne plafon dhe te gjitha elementet tjera te varura ne plafon. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	2.6	€ 10.00	€ 26.00
7	Pastrimi i plafonit nga mbetje te ndryshme inerte. Materiali duhet te bartet deri ne deponine me te afert legale.	m2	2.6	€ 10.00	€ 25.50
8	Furnizimi me material, pastrimit, izolimi dhe ngjyrosja e mureve dhe plafonit te hapsires me baze dhe dy shtresa ngjyre dykomponenteshe akrilike. Ne cmim te kalkulohet edhe grryerja dhe permirsimi i murit, intervenimi me fug fuller dhe glet per permirsimin e pjeseve te demtuara te murit. Eliminimi i lageshtise ne perimetrimin e mureve permes aparatures per eliminimin e lageshtise e cila duhet te aplikohet minimalisht 10 dite.	m2	17.3	€ 15.00	€ 259.50
9	Furnizimi, transporti dhe montimi i laminatit me fuga, trashësi d=8mm, llajsnave anesore si dhe folisë. Ngjyra dhe tekstura te zgjidhen nga investitori. Në çmim të llogaritet të gjitha pjesët e nevojshme. Pagesa bëhet për m² të montuar komplet	m2	2.6	€ 35.00	€ 91.00
10	Furnizimi me material dhe aplikimi i plafonit te leshuar te tipit "Armstrong" ne te gjithë siperfaqen e plafonit. Ne cmim te kalkulohen demontimi i konstruksionit ekzistues dhe pjeset perçjellëse te konstruksionit deri ne perfundim te plote te pozicionit. Mbi konstruksionin e armstrongut te vendoset folia mbrojtëse e cila shërben per mbrojtjen e plafonit armstrong nga lageshtia.	m2	17.3	€ 35.00	€ 605.50
11	Furnizimi, transporti dhe montimi derës me mbindriqim prej konstruksionit të drurit me panele mbeshjtëse mekanike rezistente, me dimensione l=0.95m dhe h=2.70m dhe ngjyre te cilën e përcakton investitori. Mbushja ne mes paneleve te sherbej per rritjen e nivelit te izolimit akustik. Dyert të punohen në bazë të detallit të dhënë. Ne cmim te kalkulohet edhe rregullimi i perimetrit te murit rreth derës pas montimit. Aproximi i atesteve dhe materialeve per te gjitha specifikat e lartcekura behet nga shfrytëzuesi.	Cope	1.0	€ 850.00	€ 850.00
12	Furnizimi, punimi i murit prej knaufi 12mm ne dy anete e konstruksionit metalik U-profileve 8cm si dhe mbushja ne mes me termoizolim me trashësi 8cm, Ne kete cmim te llogaritet edhe gletimi i murit ne dy anet si dhe ngjyrosja e te njejtut me ngjyre te bardhë.	m2	1.6	€ 65.00	€ 105.30
HAPSIRA NR.4					
1	Largimi(Levizja) e inventarit dhe mbetjeve tjera nga salla/zyra deri ne perfundim te plote te punimeve dhe bartja e tyre deri ne deponine me te afert legale. Varesisht kerkeses te mbikqyresit te punimeve.	komplet	1.0	€ 2,000.00	€ 2,000.00
2	Demolimi i shtresave te dyshemese deri te pllaka e Betonit dhe pregatitja e dyshemese sipas nevojës per montimin e dyshemese se re.	m2	5.4	€ 10.00	€ 54.12
3	Demolimi i tapeteve te murit dhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	25.2	€ 5.00	€ 125.82

4	Demontimi i ramit nga druri dhe xhami dhe deres se bashku me kornize dhe xhamin e mbindriqimit. Transporti i materialeve deri ne deponine me te afert legale.	Cope	1.0	€ 50.00	€ 50.00
5	Demolimi i plafonit te varur ekzistues nga kapaket e knaufit. Ne cmim te kalkulohet edhe bartja e materialit deri ne deponine me te afert legale.	m2	5.3	€ 10.00	€ 52.80
